PANAIRI I EDUKIMIT
EDUCATION FAIR

REZYME / RESUME

E ardhmja e juaj fillon tani!
Your future starts now!

19-20 PRILL / APRIL **2018**

Salla 1 Tetori Prishtina - Kosovo

12 VJET YEARS

WWW.CEOKOS.COM

Me moton e ardhmja e juaj fillon tani, Kompania Congress & Event Organization përmbylli me sukses edicionin e 12 – të me radhë të panairit ndërkombëtarë të Edukimit, i cili u mbajt në datat 19-20 Prill në sallën 1 Tetori në Prishtinë.

Si aktiviteti i vetëm në vend i cili promovon fushën e edukimit, edhe këtë vit ky panair hasi në përkrahjen e institucioneve më të rëndësishëm në këtë fushë siç janë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Komuna e Prishtinës, Drejtoria për Arsim.

Në hapjen solemne të këtij panairi ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqri Bytyqi e konsideroi këtë ngjarje si një mundësi të mirë për orientim të të rinjve në universitete të përshtatshme të cilat siç tha ai bëjnë përgatitje cilësore për tregun e punës.
“Sot është një ditë e madhe një ditë e mirë sepse po fillon panairi. Kjo traditë e panaireve po tregon që ne jemi në rritjen e standardeve, por edhe të rijntë tanë kanë të drejtë t`i kenë informatat në kohë. Në veçanti nga ajo që po

With the motto Your future starts here, CEO Company - Congress & Event Organization successfully closed the 12th edition of the International Education Fair, which was held on 19-20th of April at the Sports Hall in Pristina.

As the only activity in the country that promotes the education field, this fair again had the support of the most important institutions in this area such as Ministry of Education, Science and Technology and The Municipality of Pristina as well, Education Directory.

At the opening ceremony of this fair, the Minister of Education, Science and Technology, Shyqri Bytyqi considered this event as a very good opportunity for the orientation of the youth at the most suitable universities, which are qualitative preparations for the job market.
"Today is a big day, a good day because the fair is starting. This fair tradition shows that we are increasing standards, but also our youth has the right to be informed in on time. In particular, what can we see from here is that we have a big participation of the professional schools. We need our youth to be oriented towards market's

Opening Ceremony
Minister of Education, Science and Technology
Mr. Shyqri Bytyqi

Në anën tjetër në fjalën e tij të rastit organizatori i panairit të Edukimit, Bekim Xhafa tha se panairi ka për qëllim të informojë qytetarët për ofertat që ofrojnë universitetet e vendit dhe të huaja. *"Qëllimi i panairit të edukimit është që t'u ofrohen qytetarëve tanë, rinisë sonë mundësi për t`u informuar direkt për drejtimet dhe për bursat që ofrojnë universitetet e vendit por edhe ato ndërkombëtare".*

On the other hand in his welcoming speech the organizers of the Education Fair, Bekim Xhafa said that the fair has the goal to inform citizens on the offers that country and foreign universities offer. *"The aim of the Education fair is to offer our citizens and our youth possibilities to be directly informed on the fields and scholarships that universities of the country offer, as well as the international ones".*

Panairi i Edukimit i këtij edicioni u karakterizua me pjesëmarrjen e institucioneve më të rëndësishme të arsimit të lartë dhe të mesëm si nga vendi por edhe ato ndërkombëtare. Përfshirja e shkollave të mesme profesionale nga komuna e Prishtinës si dhe të gjitha shkollave të kompetences nga i tërë territori i Kosovës e bëri edhe më të larmishëm panairin.

Por për ta plotësuar edhe më shumë pjesën edukativo-arsimore, panairi i Edukimit është kujdesur që të përfshij edhe qendra trajnuese, kurse për aftësim në informatikë, institute si dhe asociacione të tjera edukative. Ndërkaq punën e tyre në këtë panair e prezantoj edhe Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur.

This Edition's Education Fair was characterized by the participation of the most important institutions of the higher and middle education from the country as well as international ones.
The inclusion of the professional high schools from Pristina Municipality as well as all competence schools from the entire territory of Kosovo, made this fair more interesting.

But to fill even more the education part, Education fair assured to include also training centers, courses for information technology, institutions and other education associations. The Agency for Vocational Education and Training and Adult Education also presented their work in this fair.

UNIVERSITY OF NOVA GORICA
SCIENTIA 1995 VINCES
Think brilliantly,
Austria
Slovenia

Ky numër i madh dhe kualitativ i institucioneve të arsimit, tërhoqi vëmendjen e vizitorëve të shumtë përfshirë nxënës, studentë, prindër dhe të tjerë të interesuar që të pasurojnë veten e tyre edhe me specializime në universitete të ndryshme botërore. Ndërkaq në mënyrë të organizuar pjesëmarrës në panair ishin nxënësit e klasëve të nënta dhe maturantët.

This large and qualitative number of education institutions attracted a high number of visitors including students, parents and others interested to enrich themselves also with specializations at the prominent world universities. Meanwhile the students of the ninth grade and graduates visited the fair in organized way.

Gjatë dy ditëve sa zgjati panairi, institucione të ndryshme arsimore për të interesuarit kishin përgatitur edhe aktivitete paralele në mënyrë që puna dhe mundësitë të cilat i ofrojnë ata të jenë sa më të qasshme për vizitorët.

During two days of the fair, various education institutions prepared for the visitors parallel activities in order for the possibilities and work that they offer to be as much as approachable as possible.

TË DHËNA MBI PANAIRIN E EDUKIMIT 2018

Organizator: CEO-Congress & Event Organization

Hapja zyrtare: 19 Prill, Ora 10:00

Vendi: Salla 1 Tetori, Prishtinë

Hapsira totale e panairit: 2500m^2

Origjina e ekspozuesve: Kosova, Shqipëria, Maqedonia,
Greqia, Bosna dhe Hercegovina, Sllovenia,
Turqia, Gjermania, **Finlanda, Latvia**

Numri i përgjithshëm i vizitorëve: 13.600

Profili i vizitorëve: nxënës, student, prindër, mësimdhënës, udhëheqës të institucioneve edukativo-arsimore

Mbyllja zyrtare panairit të Edukimit: 20 Prill, Ora: 18:00



Education Fair in media

Education Fair in Tv: RTK, KTV, Klan Kosova, Tv Dukagjini, RTV 21,T7

Radio: Radio Kosova, Radio Dukagjini

News Agencies, newspapers and Informative portals:
Koha Ditore, www.kosovapress.com, www.koha.net, www.gazetaekonomia.com, www.epokaere.com, www.kosovap
www.arbresh.info, www.ekonomiaonline.com, www.botasot.info, www.orainfo.net, www.xlpress.tv, www.gazetaprojek
www.manager.ba, www.progradnja.hr, www.eworldtrade.com, www.digisilkroad.com, www.eventegg.com,

DATA ON EDUCATION FAIR 2018

Organizator: CEO-Congress & Event Organization

Official opening: 19 of April, at 10:00

Place: Hall 1 Tetori, Pristine

Total exhibition space: 2500m^2

Origin of the exhibitors: Kosovo, Albania, Macedonia, Greece, Bosnia & Hercegovina, Slovenia, Turkey, Germany, Finland, Latvia

Number of visitors: 13.600

The profile of the visitors: students, parents, managers of education institutions

Official closing of the Education Fair: 20th of

ost.net,
kti.com,

Shihemi ne edicionin e radhës
See you in the next Edition